

Fakulteti: Fakulteti i shkencave sociale

Lënda: Lojërat dhe lodrat, Profesori i lëndës, Mr. Emrush Xhemajli

Java IV

Njësia. : LOJERAT DHE ZHVILLIMI I AFTESIVE FIGURATIVE FEMIJERORE

Një pjesë të lojërave femiore kanë të bëjnë me figuracionin. Gjatë këtyre lojërave figurative nxirren shumë perfundime për gjendjen, jetën e fëmijut. Kirshenshtajneri¹ i pari bëri analizën detajë të zhvillimit të paraqitjes së disa objektivave në vizatime fëmijërore. Krijimi figurativ fëmijëror nëse është ilirë dhe spontan është rezultat i jetës psikike të fëmijës.

Fëmijët që kanë të ushtruar dhe të mprehtë aftësinë e të vërejturit e kanë më të zhvilluar shkathtësinë e duarve dhe kanë veti që më fuqishëm ta shprehin botën e brendshme.

Megjithatë vizatimi nuk është vetëmi indikator dhe parametër për të gjykuar zhvillimin e një fëmije. Megjithatë, përmes tyre mund të vërtetohet niveli i aftësive figurative të fëmijëve.

Shprehja figurative tregon një shkallë të caktuar të zhvillimit psikik dhe fizik, ndërkajsh për të parën herë fshaqet në formë të thjeshtë në moshën dy vjeçare.

Tri fazat nëpër të cilat kalon vizatimi fëmijëror.

1. Faza e shkarravitjeve, gjerë në moshën tre vjeçare,
2. Faza e skematizimit, gjerë në vitin e parë të shkollës dhe
3. Faza e trajtave dhe e dukurive, gjerë në pjekuri.

Ndërsa shkencëtari Like përdorë terma tjerë për këto faza zhvillimi

- a. Realizimi spontan, gjerë në moshën tri vjeçare
- b. Realizimi i pasuksesshëm, gjerë në moshën pesë vjeçare
- c. Realizimi vizuel, gjerë në moshën dhjetë vjeçare.

¹Georg Kerschensteiner (1854 - 1932) teoricien i edukimit.

Pos këtyre kritereve të përmendura, po ashtu mund të përcillet zhvillim I ishprehjes së fëmijës duke pasur parasyshë mbizotërimin gradual të të pamit mbi dukuritë shfaqjet motorike²

Për të përcjellur zhvillimin e aftësive figurative të fëmijëve shfrytëzohen këto metoda të punës hulumtuese-shkencore:

1. Të vërejturit dhe vetëvërejturit pedagogjik,

Metodat më të thjeshta të hulumtimit shkencor në kulturën figurative ku hulumtohet dukuria e të vërejturit dhe vetëvërejturit pedagogjik janë **metoda përshkruese** dhe **metoda shkajkore**.

a. Metoda përshkruese (descriptive)

- i. Me këtë metodë përshkruhen dhe konstatohen faktet pa gjetjen e shkakut të asaj dukurie.
- ii. Kjo metodë mund të shfrytëzojmë sidomos për ato dukuri të cilat nuk mund ti masim dhe vlerësojmë realisht.

b. Metoda shkajkore (kauzale).

- i. Kjo metodë, gjatë hulumtimit, përqëndrohet në arsyet, shkaqet nga të cilat ndonjë dukuri apo formë zhvillohet.
- ii. Kjo metodë është më komoplekse sepse duhet thelluar në zbulimin e shkaqeve të dukurive dhe krahasimin e tyre.

2. Të studjurit e vizatimeve të fëmijëve dhe dokmuntacionit shkollor

Shumë shkencëtar kanë përpunuar metodat e hulumtimit shkencor të punimeve të fëmijëve.

Rutman numëron këto metoda:

a. Metoda monografike

²Vetite motorike. Fiziol. Dukuri fiziologjike që lidhen me lëvizshmërinë e gjallërine e trupit ose të organeve a gjymtyrëve të tij.

- b. Statistikore
- c. Metoda etnologe,
- d. Metoda biografike
- e. Metoda eksperimentale –estetike
- f. Analiza intelektuale e vizativeve të fëmijëve

Në bazë të të mbledhurit dhe analizave të punimeve, vizatimeve të fëmijëve, rrethanave të tyre të ndryshme, mund të vërtetojmë se cilat motive dominojnë, të fshatit apo të qytetit, femrave apo meshkujve (sipas gjinisë).

Nga punimet e fëmijëve mund të vërtetojmë se a është rrethidhanun pas fëmiut dhe cili është raporti ndaj individëve të rrethinës së vet me te. Motivet e kësaj natyre janë: njeriu, djali, vajza, shtëpia, druri, rruga, rrethoja, kafshët etj.

Fëmijët duke komentuar këto motive zbulojnë edhe raportin e vet ndaj tyre.

Punimi i fëmiut në temën autoportret apo “shoku më i mirë” zbulon marrëdhënjet – raportin e fëmiut ndaj vehtes apo të asaj që është me e afër për te.

Punimet figurative femërore dhe gjendja emocionale e fëmiut shprehen kur fëmiu në to shprehet përmes theksimit të ndonjë detaji, të ndonjë ngjyre apo vije të caktuara. Gjithashtu kjo gjendje paraqitet me **drejtimin e vijave** që përdor e që secila ka domethënjen e vet.

3. Eksperimentit pedagogjik,

- i. Përfshinë metodat më të përshtatshme të të edukuarit, mësuarit.

4. Kontakti me faktor që ndikojnë dhe përcjellin zhvillimin figurative të fëmijëve:

- i. Këtu hynë kontakti me rrethin, shoqërinë, natyrën, objektet...

TIPET E FEMIJEVE SIPAS KRIJIMTARISE FIGURATIVE

- 1. Tipi Vizuel.

- i. Tipi fëmijëve vizuel, sipas krijimtarisë figurative është i prirur dhe bënë shënime pasive nga përshtypjet dhe shpeshherë mund të ngjajë që ky tip të bëjë imitimin natyral dukemos e angazhuar fare intelektualin.
- ii. Vizatimet e fëmijëve të tillë në pikëpamje objektive janë të sakta, por pa shqetësime dhe qëndrime. Në këtë rast detyrë e edukatorit është që te këtë tip të fëmijëve ta angazhojë me materiale të ndryshme për t'i ikur, pra për të dalë nga pasiviteti.

2. Tipi imagjinativ

- i. Ky tip mbështetet në fantazinë dhe të menduarit e fëmijëve. Tek ky tip paraqiten format e prera si dhe ngjyrat e temat që janë në të kundërtën merealitetin.

3. Tipi analitik

- i. Fëmijët e këtij tipi fillojnë nga paraqitja e objektit prej detajeve nga tërësia. Më së miri vie në shprehje gjatë të punuarit të pejsazheve natyrore.

4. Tipi sintetik

- i. Ky tip jep rëndësi brendësisë së objektit dhe fillon nga tërësia duke paraqitur format e detajet më karakteristike.

5. Tipi intelektual

- i. Fillon nga të menduarit për punën që duhet të vijë më vonë. Planifikon mirë punën e vet dhe ato realizon duke paraqitur një renditjen gjeometrike (objektet dhe figurat).

6. Tipi ekspresiv

- i. Fillon nga përjetimet dhe përshtypjet e veta në të njëjtat mbështetet gjatë realizimit të punimeve. Te ky tip dallomjë dy variant:
 - a. *Paraqitja brutale dhe e fortë*
 - b. *Paraqitja epiko-lirike*

7. Tipi kolorik

- i. Ky tip fëmijëve bazohet te ngjyra. Përjetimin e saj e shpreh duke zgjedhur tonet e ngjyrave me të cilat punon.

8. Tipi grafik

- i. Ky tip për bazë ka vijën me të cilën shprehet dhe nëpërmjet saj është shumëisigurtë.

9. Tipi konstruktiv

- i. Partaqet formën e qartë dhe lidhshmërinë në mes tyre, sidomos te objekteve në hapësirë.

10. Tipi impulsive

- i. Shprehet në bazë të ndjenjave mtorike, impulsive dhe përjetimeve intelektuale.
- ii. Ky tip ështëiftohet dhe racional por mund të parqitetingrohtë dhe lirik

11. Tipi dekorativ

- i. Shprehet në bazë të interpretimeve optike të hapësirës. Fëmijët e tillë kanë afinitet të caktuar për dekor dhe në mënyrë shumëdimensionale paraqet hapësirën.

12. Tipi hapsinor.

- i. Disa fëmijë shkojnë nga ajo që hapsirën ta paraqesin duke e përjetuar me të gjitha elementet figurative dhe këtë tip të fëmijëve e quajmë tipihapsirës.

Në entet parashkollore edukatorja përmes detyrave që jep duhet të përcjellë punën e fëmijëve dhe të përcaktojë karakteristikat figurative, përkatësisht tipet e tyre.

VLERESIMI I PUNIMVE TE FEMIJEVE**1. Vlerësimi i punimeve në aspektin psikologjik**

- a. Vizatimet ne forme shkarravitjejeipërgjigjet moshes 2-3 vjeçare,
- b. Format rrethore te vizatimeve shfaqen zakonisht nga mosha 3 deri ne moshen 5 vjec.
- c. Gjate moshes 4-5 vjet paraqitja e figures se njeriut femijet fillojne tu paraqesin floket, veshjen etj.
- d. Pas kesaj vjen deri te paraqitja e përmbajtjeve te objekteve ne hapssire.
- e. Paraqitja e temperamentit, ndjenjave, karakterit, deshirave.

- f. Motivët e vizatimeve zakonisht janë: shtëpia, fëmija, shoku, autoportreti, ku edukatorja mund të vërejë qëndrimin e fëmijut për to.
2. Vlerësimi i punimeve nga aspekti pedagogjik
 - a. Përmes vlerësimit pedagogjik të krijimeve figurative vërehet ndikimi pozitiv ose edhe ndikimi i keq në zhvillimin e tyre.
 3. Vlerësimi i punimeve nga aspekti **estetik**³
 - a. Gjaë vlerësimit estetik duhet të kemi parasyshë të gjithë elementet e shprehjes figurative dhe elementeve të parimeve figurative duke filluar nga vija, ngjyra etj. Apo harmonia e kontrastit etj...

Analiza e kombinuar e punimeve të fëmijëve, nga të gjitha aspektet, sjell vlerësimin më të sakt dhe arrinë rezultat më të lartë.

PARIMET NE METODIKEN E KULTURËS FIGURATIVE.

Mediumet me të cilat trasmetohen dituritë:

1. Fjala e folur dhe e shkruar (të shprehurit gojor, biseda dhe puna me tekst)
2. Figura, piktura/fotografia dhe mjetet tjera vizuale (ilustrimet dhe demonstrimet) dhe
3. Puna e vet individuale (aktiviteti figurative – puna grafike dhe laboratorike).

Metodat që përdoren te fëmijët parashkollor në lëmin e kulturës figurative i grupojmë në tri njësi:

1. Metoda verbale – tekstuale
 - a. Përdorimi i fjalës së gjallë (dialog – monolog)
 - b. Mënyra e ndryshme e përdorimit të teksteve.
2. Metoda ilustrativo-demonstruese
3. Metoda eksperimentale – tipet praktike

³ Estetik/ë, - filoz. Shkenca që studion të bukurën në natyrë e në jetën shoqërore, ligjet e përgjithshme të krijimtarisë artistike e të përvetësimit estetik të realitetit dhe përmbajtjen, rrugët e format e edukimit estetik: Shkenca që studjon të bukurën (Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980)

PARIMET DIDAKTIKE⁴ NË METODIKEN E KULTURES FIGURATIVE

Edukatorët/et, duhet të percjellin me kujdesë fëmijët në lojë të figurative me qëllim që të zhvillojnë sa më mirë aftësitë e tyre. Kjo duhet të bëhet duke pasur parasyshë parimet didaktike të mëposhtme të cilat janë vërtetuar të sukseshme nga pedagogët dhe puna praktike me fëmijë.

1. Parimi i kualitetit dhe orientimit edukativ

- i. Parimi i kualitetit dhe orientimit edukativ nënkupton orientimin në kreativitet dhe në kultivimin e vlerave dhe ndjenjave pozitive me qëllim të zhvillimit të prirjeve dhe aftësive. Nga ana tjetër duke ruajtur fëmijët nga **kiçi**⁵, imitimi apo të kopjuarit pasiv sepse ato negativisht reflektohen në edukimin e personalitetit dhe të kulturës së tij figurative.

2. Parimi i të shprehurit të lirë figurative

- i. Në fillim të shekullit XX paraqitet parimi i të shprehurit të lirë të fëmijëve.
- ii. Detyrë e edukatores është të nxis të shprehurit e lirë dhe kreativ pa ndërhyrje të shemave të gatshme dhe shablloneve, por këtë duhet bërë me orientim të lehtë.

3. Parimi i sistematizimit, paraqitjes dhe përshtatshmerisë ndaj moshës

- i. Kjo nënkupton përshtatjen e kërkesave të edukatores për fëmijët në përshtatje me moshën, si në sistemimin e tyre dhe të dijeve që jep dhe kërkon pa i ngarkuar për detyra që ata ende nuk mund t'i kryejnë.

4. Parimi i vetëdijes dhe i kreativitetit

⁴ Shih shpjegimin për fjalën “didaktikë” në Ligjeratën paraprake

⁵ Kiçi është fjalë që përdoret për të treguar artin pa kriteret e nevojshme profesionale, artin pa shije dhe të zveshur nga vlerat njerzore, artistike etj. Gjithashtu përdoret për të treguar artin komercial i cili fitimin e bazon në dëm të kualitetit.

- i. Për të arritur këtë edukatorja duhet që në një pjesë të kohës të kërkojë që fëmijët të mendohen vetë të vendosin se çka dhe si të punojnë.

5. Parimi individualitetit dhe I socializimit (shoqërorizimit)

- i. Sipas parimi fëmiju duhet të aftësohet të punojë vetë, individualisht dhe gjithashtu edhe në grup, të tijë të përshtatet në punë me të tjerët, të harmonizojë veprimet dhe mendimet.

6. Parimi të vërejturit dhe I abstrakcionit.

- i. Ky parim lidhet me detyrën e edukatorës për zhvillimin e aftësisë për të vërejtur, rrokur dukurinë dhe për të përgjithësuar ato. Ky parim lidhet me kufijtë e dijes e kreativitetit.